

GJYKATA TURKE E LLOGARIVE – PARTNER DHE MBËSHTETËS KRYESOR NË TRAJNIMIN E AUDITUESVE SHQIPTARË JASHTË VENDIT

nga Albana GJINOPULLI – Përgjegjëse sektori dhe Alfanc GABILI – Auditues i parë botuar në gazetën “Ekonomia”, më 10 maj 2014.



Cila është TCA- Gjykata Turke e Llogarive?

E krijuar më 29 maj 1862 nga Sulltan Azisi I-rë, Gjykata Turke e Llogarive/The Turkish Court of Accounts (TCA) u kthye në Institucion Kushtetues me hyrjen në fuqi të Kushtetutës Otomane në vitin 1876, dhe pas themelimit të Republikës Turke më 1923, TCA u riformatua duke e ruajtur statusin e saj ne Kushtetutën e Republikës.

Bazuar në Kushtetutë dhe në Ligjin e Gjykatës së Llogarive, TCA ka përgjegjësinë për të audituar në emër të Asamblesë së Madhe Kombëtare (Parlamentit), të ardhurat, shpenzimet dhe pasurinë e njësive qeverisëse të cilat funksionojnë si nën buxhetet e përgjithshme dhe specifike të shtetit.

Si auditues të jashtëm të qeverisjes qendrore dhe lokale, stafi i TCA-së auditon afërsisht 12,000 llogari të sektorit publik.

Mandati që i ofron statusi TCA-së, është kryerja e auditimeve të rregullshmërisë mbi bazën e ekzaminimit 100% të transaksioneve, pra të gjitha faturave, dokumentacionit të tyre shoqërues, ditarëve, llogarive dhe deklaratave financiare. Me ndryshimet e bëra në Ligjin e TCA-së në vitin 1996, asaj iu dha detyra për të zgjeruar ekzaminimin e njësive shtetërore që ishin nën juridiksionin e saj, për auditimin e përdorimit të burimeve me ekonomi, efikasitet dhe efektivitet.

Veprimtaria e TCA-së mbështetet në buxhetin e saj specifik, por pavarësia e saj financiare mbështetet në faktin se ky buxhet përgatitet nga vetë TCA dhe miratohet

nga Parlamenti, pra pa asnjë ndërhyrje te ekzekutivit. Presidenti i TCA është i vetmi autoritet urdhërues për kryerjen e shpenzimeve.

Burimet njerëzore/stafi i TCA përbëhet nga pjesa e stafit profesional në të cilin përfshihen Presidenti, Anëtarët dhe audituesit dhe përbëjnë 565 staf profesional (57 gjyqtarë dhe 508 auditues) dhe stafi mbështetës të cilët në total arrijnë në 697 persona.

TCA është një Institucion Suprem i Auditimit i pajisur me fuqinë juridike, dhe nuk është subjekt i rishikimeve administrative dhe politike. Për shkak të pavarësisë në tre anët e qeverisjes ekzekutivit, legjislativit dhe gjyqësorit, audituesit e TCA-së kanë diskrecionin e plotë për të vendosur se cilat llogari dhe subjekte do të auditohen dhe kur, gjithashtu dhe në Raportimin tek Parlamenti kur është e nevojshme. Ata gjithashtu planifikojnë në mënyrë të pavarur punën e tyre dhe kanë të drejtën të komunikojnë me ministritë, bordet dhe njësitë qeverisëse. Ata gjithashtu kanë akses të pakufizuar për të ekzaminuar të gjitha llogaritë dhe dokumentacionin e nevojshëm për të kryer funksionin e tyre.

TCA raporton tek Parlamenti dhe produktet e punës së saj reflektohen në raporte të formave të ndryshme si:

- Raporti i Vlerësimit të Përgjithshëm te Auditimit të Jashtëm;
- Raporti i Vlerësimit të Përgjithshëm te Aktiviteteve;
- Raporti Vlerësues për Statistikat Financiare;
- Deklarata e Përgjithshme e Pajtueshmërisë;
- Raportet e Ndërmarrjeve Shtetërore.

TCA është anëtare e INTOSAI-t dhe dy prej Grupeve të Punës Rajonale; EUROSAT-t dhe ASOSAI. Gjithashtu TCA është një prej themeluesve të ECOSAI-t.

Presidenti aktual i TCA, Prof. Akyel përfaqëson një personalitet shumëdimensional të auditimit suprem ndërkombëtar dhe ndër partnerët e huaj më me kontribute për Kontrollin e Lartë të Shtetit. Ky kontribut ka sjellë rritjen e dukshme të kapaciteteve profesionale të audituesve të KLSH dhe modernizimin e Institucionit, në nivel me standardet e INTOSAI-it (Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit).

Mirënjohja dhe vlerësimi këtë partner të rëndësishëm të Shqipërisë dhe KLSH, janë shprehur dhe nga drejtuesit më të lartë të shtetit shqiptar dhe botës akademike.

Ndaj një personaliteti si Presidenti i Gjykatës së Llogarive të Turqisë, Prof. As. Dr. Recai Akyel, më 4 qershor 2013, nga Presidenti i Republikës, z. Bujar Nishani iu akordua “Medalja e Mirënjohjes”, me motivacionin: “Për kontributin dhe ndihmesën e çmuar në përparimin e Institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, duke nënvizuar se partneriteti dhe bashkëpunimi janë fundamentale dhe të pazëvendësueshme për forcimin e institucioneve kushtetuese dhe theksuar domosdoshmërinë që ka bashkëpunimi mes institucioneve të auditimit në shërbim të transparencës dhe mirëadministrimit të pasurive publike të qytetarëve. Gjithashtu Prof. As. Dr. Recai Akyel, u vlerësua dhe nga Universiteti Politeknik të Tiranës, kur Rektori i këtij Universiteti, Akademiku Prof. Dr. Jorgaq Kaçani, në emër të Senatit të Universitetit, i dha titullin “Honoris Causa”, për kontributin e tij të qenësishëm në zhvillimin e praktikave moderne të auditimit suprem në nivel evropian dhe botëror, nëpërmjet bashkëpunimeve të frytshme dhe ndihmesës profesionale dhe për shumë institucione supreme auditimi, ndërmjet tyre edhe me KLSH.

TCA dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit

Vitet 2012 -2013 shënuan një periudhë mjaft produktive në marrëdhëniet e KLSH me institucionet dhe organizmat ndërkombëtare dhe me Institucionet Supreme të Auditimit. Në mënyrë të veçantë disa prej marrëveshjeve të nënshkruara me SAI-t homologe kanë qenë sa frytdhënëse aq dhe impenjuese për stafin e KLSH.

Në sajë të impenjimit të lartë dhe vullnetit të dy drejtuesve për bashkëpunim, marrëdhëniet mes dy institucioneve të auditimit, Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Gjykatës Turke të Llogarive kanë ardhur duke u forcuar. Në muajin nëntor të vitit 2012, u nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit midis Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Gjykatës Turke të Llogarive. Rezultat konkret i Marrëveshjes ka qenë kualifikimi i dhjetëra audituesve të KLSH-së në Ankara, të cilët nën përkujdesjen e drejtpërdrejtë të Prof. Akyel, por edhe të një stafi të përkushtuar dhe të lektorëve profesionistë të Gjykatës Turke të Llogarive, janë trajnuar në fushën e Auditimit të Performancës, të Auditimit Financiar dhe të Auditimit të Prokurimeve Publike, duke përmirësuar dhe përforcuar ndjeshëm dijet e tyre në këto fusha dhe, për rrjedhojë, duke kontribuar në rritjen e cilësisë së punës audituese të KLSH në tërësi.

TCA ka qenë kontribuesi kryesor në mbështetjen e stafit të KLSH me trajnime dhe vizita studimore të cilat zënë rreth 50% të të gjithë volumit të trajnimeve jashtë vendit. TCA bëri të mundur që gjatë kësaj periudhe 20 mujorë të organizohen pranë zyrave të TCA-së në Ankara pesë trajnime ku u njohën me eksperiencën dhe

përvojën audituese rreth 85 auditues të KLSH për mesatarisht 5 ditë trajnimi/person.

Fillesat e bashkëpunimit të gjerë institucional shënojnë muajin dhjetor 2012. Në këtë aktivitet të parë u trajnuan 16 auditues për një periudhë një javore në lidhje me auditimin e performancës si një nga fushat e reja dhe me të paprekura nga audituesit Shqiptarë. Në aktivitetin e dytë të organizuar dy muaj më pas, në shkurt 2013, u bë i mundur trajnimi 5 ditor i 16 audituesve shqiptarë në fushën e auditimit financiar. Trajnimi përfshiu aspekte të ndryshme të kryerjes së auditimeve financiare si: Objektivat e një Auditimi Financiar dhe Grafiku i Procesit të Auditimit, Kuptimi i ambientit kontrollues të entitetit që do auditohet, Zonat e Llogarive (të ndjeshme dhe jo të ndjeshme), Plani dhe Programi i Auditimit, Modeli i Sigurisë së Auditimit, Testet e Kontrollit, Mbledhja e Evidencave të Auditimit, Rishikimi i Auditimit dhe Dokumentacionit, Materialiteti, Përzgjedhja e Shembujve, Vlerësimi i Rezultateve të Auditimit, Raportimi dhe Vlerësimi i Riskut. I vlerësuar lart nga pjesëmarrësit vetëm dy muaj më vonë dy trajnime të njëpasnjëshme do të zhvilloheshin në drejtim të çështjeve mjaft të rëndësishme dhe të prekshme në praktikën e auditimeve. Trajnimi “Auditimi i Pajtushmërisë dhe Auditimi i Prokurimeve Publike”, i zhvilluar në muajin Maj 2013 mbuloi çështje specifike si: Përcaktimi dhe parimet e auditimit të pajtushmërisë, Planifikimi i auditimit të pajtushmërisë, Vlerësimi i riskut, Dëshmia e auditimit, Përfundimet e auditimit, Vlerësimi i përfundimeve të auditimit, Korniza e përgjithshme e auditimit të prokurimeve publike, Auditimi i prokurimeve publike për mallrat, shërbimet dhe punimet. Për një periudhë 5 ditore, 21 auditues shqiptarë trajtuan probleme të ndryshme me të cilat janë përballur gjatë auditimeve të përputhshmërisë dhe në veçanti në vlerësimin e prokurimeve publike. Shkëmbimi i eksperiencave u vlerësua mjaft i dobishëm për t’i dhënë përgjigje shumë prej çështjeve me të cilat audituesit përballen në çdo vend përsa i përket këtyre fushave të auditimit dhe bëri të mundur që për të njëjtat probleme të përdoret eksperiencia e kolegëve Turq në zgjidhjen e tyre.

Në vijim, nuk mbeti jashtë vëmendjes dhe trajtimi i çështjeve të përgjithshme të auditimit dhe administratës publike për të cilin u trajnuan nga audituesit kolegë turq në një periudhë 3 ditore, 18 persona staf auditues dhe mbështetës i KLSH.

Objektivat e zhvillimit strategjik të KLSH, dhe ndryshimet e pritshme kanë vëne në fokus njohjen dhe zhvillimin e njohurive të audituesve me Sistemet e Informacionit dhe Auditimin e tyre. Për këtë qëllim, në prill të këtij viti trajnimi prej 5 ditësh,

pranë TCA-së mundësoi që 13 auditues shqiptarë, të njiheshin nga afër me eksperiencat turke në drejtim të menaxhimit dhe kryerjes së auditimit të Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit. Ky trajnim përfshiu njohuri në drejtim të: Menaxhimit të Teknologjisë së Informacionit (TI) dhe Projekteve të saj, Ndërgjegjësimi i TI, Risqet e bazave të TI, Kontrollat e TI, Metodologjia e Auditimit të TI, Teknikat e Auditimit me ndihmën e Kompjuterit. Pjesës teorike të trajnimit iu bashkëngjit dhe trajtimi praktikë me demonstrimin e programit të menaxhimit të auditimit që TCA përdor, të quajtur SAYCAP.

Duke u vlerësuar tepër aktuale moton e INTOSAI-t ***“Experientia mutua omnibus prodest”***, përvoja e dhe mbështetja e ofruar nga TCA për audituesit e KLSH, dëshmon për një praktikë tepër frytdhënëse që në KLSH do të vijojë të aplikohet në të ardhmen me të tilla institucione dhe të tjera, duke e konsideruar shkëmbimin e eksperiencës dhe trajnimin nga kolegët e institucioneve homologe si një nga faktorët kryesorë për rritjen dhe zhvillimin profesional të stafit auditues dhe cilësinë e punës.